



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **E Drejta Ndërkombëtare (2023-2024)**

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i tretë (doktoratë)
SETK	180
Kodi	N-PhDLAWIL180C
Titulli	Doktor i Shkencave Juridike / Drejtimi: E Drejta Ndërkombëtare
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-3482/1
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	28.09.2023

Përshkrimi i programit

Programi studimor *e drejta ndërkombëtare* synon të ofrojë një gamë të moduleve që do ta përfshijnë bazën e të dijeve ndërkombëtare juridike për afrimin drejt profesionet juridike dhe profesionet që lidhen me lëmin e të drejtës ndërkombëtare dhe të sigurojë njohuri të fuqishme, të veçanta dhe sistematike për institucionet dhe konceptet e së drejtës ndërkombëtare, si dhe mbi gjendjen dhe perspektivën e tyre në rajon dhe botë.

Karriera

Diploma e programit studimor do t'u mundësojë studentëve të studimeve të doktoratës që të aftësohen për punën hulumtuese shkencore në lëmin e shkencave juridike ndërkombëtare dhe për mësimdhënie në universitetet në vend dhe jashtë vendit, me ç'rast aktivisht do të jenë të kyçur edhe në procesin e fuqizimit të burimeve të veprimtarive të pushtetit shtetëror në drejtim të procesit të integritetit euroatlantike të vendit.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri solide nga disiplinat që e sajajnë të drejtën ndërkombëtare, përfshirë të drejtën e organizatave ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare publike, të drejtën ndërkombëtare private, të drejtën ndërkombëtare penale, të drejtën ndërkombëtare ekonomike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.
- Ka njohuri të thelluara për teknikat dhe metodat e avancuara të hulumtimit në lëmin e së drejtës ndërkombëtare.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Interpreton në frymë kritike teoritë e së drejtës ndërkombëtare, si dhe rastet më të rëndësishme nga praktika.
- Zbaton njohuritë teorike në situata të ndryshme praktike që paraqiten në lëmin e së drejtës ndërkombëtare si

mbrojtjen e të drejtave të njeriut, diplomacinë, zgjidhjen e kontesteve dhe kolizionin e ligjeve përfshirë negociatat dhe mediacionin.

- Sintetizon njohuritë e fituara dhe i zbaton ato në rrethana konkrete.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ka mendim më të zhvilluar kritik përmes metodës së analizës dhe të krahasimit.
- Zhvillon shkathtësi për zgjidhjen e problemeve përmes praktikës së zgjidhjes së rasteve më komplekse nga jurisdiksioni dhe praktika gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare.

Aftësitë e komunikimit

- Përdor terminologji adekuate për çështje komplekse dhe specifike në sferën e shkencave juridike-ndërkombëtare.
- Angazhohet aktivisht në argumentimin dhe në debatin shkencor.
- I përdor gjuhët zyrtare të universitetit dhe ka shkathtësi të avancuara të teknologjive të informimit në punën shkencore.

Aftësitë e të mësuarit

- Zhvillon rregullorë të punës kërkimore që përdoret në profesionin e tij.
- Zhvillon një praktikë të mësimit të vazhdueshëm duke u angazhuar në trajnimin e personave, që punojnë në shërbimet diplomatike-konsullore të shtetit.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [DLAW0101] [10.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [DIL0102] [10.0 SETK] **E drejta ndërkombëtare publike - programi i thelluar**
- [E2775] [10.0 SETK] **E drejta ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [DIL0103] [10.0 SETK] **E drejta ndërkombëtare private - programi i thelluar**
- [C2369] [10.0 SETK] **E drejta e BE-së**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [DIL0104] [10.0 SETK] **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**
- [C2378] [30.0 SETK] **Punë kërkimore-shkencore**

Semestri 4

- [PHD-S3-S4-03] [15.0 SETK] **Publikime I**
- [C2019] [5.0 SETK] **Mobiliteti i studentëve**

Semestri 5

- [DIL0105] [20.0 SETK] **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**
- [PHD-S5-01] [10.0 SETK] **Publikime II**

Semestri 6

- [IL-PhD-THESIS] [30.0 SETK] **Disertacioni i doktoratës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë është dizajnuar për studentët që përgatiten për punimin e projekt tezës së doktoratës. Qëllimet kryesore të lëndës janë që studentëve t'u ofrohen vegla për konceptualizimin e tezës së tyre në raport me gjetjen e pyetjes hulumtuese dhe krijimin e metodave për mbledhjen e të dhënave për analizë cilësore. Lënda fokusohet në problemet e metodave sasiore dhe të teknikave, siç është analiza statistikore, tekstet që lidhen me teorinë dhe testimin e hipotezave. Me rëndësi janë edhe temat për inferencë deskriptive dhe kauzale, hulumtime longitudinale krahasuese dhe studime të rastit. Informacione të avancuara, do të ofrohen për mbledhjen e të dhënave duke punuar në tekst. Qëllimi është analiza e të dhënave sasiore, vendosja finale e të gjitha veprimeve teorike dhe praktike në dizajnimin dhe shkrimin e tezës.

- **E drejta ndërkombëtare publike - programi i thelluar**

Deri në fund të programit, studentët do të fitojnë njohuri dhe kuptim për të gjitha segmentet e së drejtës ndërkombëtare siç janë: të drejtat e njeriut, organizatat ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara dhe organet e tyre, funksionimin e institucioneve të së drejtës ndërkombëtare dhe krijimin e saj, ligjin diplomatik, e drejta penale ndërkombëtare., e drejta humanitare, rregullat thelbësore të rëndësishme për fushat kryesore të së drejtës ndërkombëtare, perspektivat teorike dhe debatet akademike që theksojnë në mënyrë thelbësore fushat ligjore, aspektet kryesore, çështjet e politikave dhe parimet që lidhen me ratifikimin e disa konventave ndërkombëtare në shtetet anëtare. Studenti do të jetë në gjendje të zbatojë me sukses njohuritë e fituara në të drejtën ndërkombëtare në shumë situata në të cilat merren parasysh problemet përkatëse praktike ose teorike. Nxënësi do të jetë në gjendje të vlerësojë problemet sipas kontekstit, rëndësisë dhe rëndësisë së tyre dhe të lidhë informacionin përkatës dhe burimet kryesore të ofruara përmes mjeteve elektronike ose mjeteve të tjera. Studenti do të jetë në gjendje të vlerësojë problemet dhe të gjejë zgjidhje që lidhen me zbatimin e ligjit ndërkombëtar në shtete, të formulojë argumente për problemet kryesore dhe fushat e diskutueshme dhe të paraqesë të menduarit racional bazuar në materialet përkatëse. Ata do të jetë në gjendje të njohë argumentet e mundshme alternative dhe provat kontradiktore sipas mendimit të tyre dhe t'i paraqesë ato. Studenti do të jetë në gjendje të demonstrojë mendje hapur dhe aftësinë për të ofruar një sfidë kritike pasi të ketë fituar njohuri për problemet individuale. Studenti do të jetë në gjendje të japë një reflektim konstruktiv të përparimit shkencor.

- **E drejta ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor**

Objektivi kryesor i lëndës është të ofrojë një kuptim bazë të veçorive kryesore dhe zhvillimit të ligjit mjedisor në një perspektivë ndërkombëtare. Objektivi specifik përkatës është të sigurojë një kuptim të ndërlidhjes ndërmjet rregullores ndërkombëtare dhe asaj evropiane. Deri në fund të kursit, studentët duhet të kenë njohuri për: •Qeverisja ndërkombëtare nëpërmjet një mjedisi jetësor shumëpalësh kontratat, duke përfshirë pajtueshmërinë dhe zbatimin; •Kompleksiteti rreth parimeve mjedisore; •Vlera dhe mangësitë e rregullimeve aktuale të të drejtave të njeriut për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë të drejtat procedurale në lidhje me vendimmarrjen mjedisore të qeverisë; •Rregullimi i gazeve serrë në nivel ndërkombëtar dhe te BE së.

- **E drejta ndërkombëtare private - programi i thelluar**

Lënda E drejta ndërkombëtare private ka për qëllim t'i mësojë studentët të identifikojnë elementin e huaj në një marrëdhënie juridike-civile dhe t'i aftësojë ata në zbatimin e metodave juridike për zgjidhjen e së njëjtës. Qëllimi është që lënda të mbulojë burime të shumta juridike në nivel nacional, evropian dhe ndërkombëtar, dhe ato të tajihoen sipas klerakisë së duhur. Tjetër qëllim i kësaj lënde është të ua paraqesë studentëve metodat, parimet dhe institutet themelore të së drejtës ndërkombëtare private; më tej të theksojë specifikat e secilës pjesë të së drejtës private ku shfaqet elementi i huaj (e drejta statusore, familjare, sendore, trashëgimore, kontraktore, deliktet, letrat me vlerë, e punës). Për më tepër, qëllimi i lëndës është njohja e studentëve me parimet juridike të zgjidhjes së çështjeve juridike-civile me element të huaj, si produrat gjyqësore kontestimore dhe jokontestimore, ashtu edhe ato jogjyqësore, si arbitrazhi dhe pajtimi.

- **E drejta e BE-së**

Qëllimi kryesor i lëndës E Drejta e Bashkimit Evropian - Programi i Aplikuar është njohja e studentëve me acquis communautaire, nga njëra anë, si dhe me pjesën procedurale në krijimin, miratimin dhe zbatimin e të njëjtit ligj, nga ana tjetër. Më konkretisht, studentët do të kenë mundësinë të njihen me sistemin juridik të Bashkimit Evropian si dhe me ligjin që gjeneron ai sistem në lidhje me vetë bashkimin, shtetet anëtare dhe qytetarët e tyre. Në të njëjtën kohë, studentët do të njihen me burimet e kësaj se drejte specifike, llojet e saj si dhe punën e institucioneve të Unionit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pjesës procedurale në miratimin e legjisllacionit të ri si dhe punës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë si gjykatë dhe organ që krijoi tërthorazi ligjin nëpërmjet gjykimeve të tij.

- **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**

Pas semestrit të dytë, studenti fillon aktivitetet e tij për përpilimin e planit mbi disertacionin e doktoratës. Aktivitetet përfshijnë përcaktimin e literaturës, përcaktimin e kornizës hipotetike, përkufizimin e metodologjisë së punës dhe përcaktimin e planit individual, si dhe prezantimin e parë publik.

- **Punë kërkimore-shkencore**

Në vitin e dytë (semestri 3 dhe 4) kandidati vazhdon me veprimtarinë kërkimore shkencore sipas planit individual të miratuar. Mentori siguron vlerësimin lidhur me këto aktivitete në formën e një raporti drejtuar Këshillit mësimesh-shkencor të fakultetit.

- **Publikime I**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmisë dhe relevancës së hulumtimit.

- **Mobiliteti i studentëve**

Qëllimi i mobilitetit të doktorantëve është të prezantojnë, shkëmbejnë dhe diskutojnë punën e tyre kërkimore me kolegë nga vendet e tjera evropiane për të përmirësuar cilësinë e disertacionit të tyre.

- **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**

Në fund të semestrit të 5-të, pas aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas planit individual, kandidati do t'i prezantojë publikisht rezultatet e përgjithshme të kësaj faze të punimit dhe të hulumtimit.

- **Publikime II**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmisë dhe relevancës së hulumtimit.

- **Disertacioni i doktoratës**

Vazhdimi i punës së disertacionit të doktoratës. Dorëzohet teza (disertacioni), pranohet nga Këshilli mësimesh-shkencor i fakultetit, u dorëzohet anëtarëve të komisionit dhe fillon procedura e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **E drejta ndërkombëtare humanitare**

Në kuadër të kësaj lënde studiohen institutet themelore të së drejtës ndërkombëtare në konfliktet e armatosura, ku përfshihen edhe konfliktet e brendshme të armatosura dhe të ashtuquajturat luftëra civile. Theksi do të vendoset në burimet e kësaj të drejte, pra në të ashtuquajturat Konventa të Gjenezës të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe Protokollet shtesë, por edhe të gjitha institutet tjera të së drejtës së luftës, si dhe mënyrat për përfundimin e konflikteve. Në kushtet e zhvillimit jashtëzakonisht të shpejtë të kësaj disipline në drejtim të përfshirjes të konflikteve të shumta të brendshme dhe rregullimin e tyre juridik nga aspekti humanitar, theks i veçantë do t'u vihet edhe konflikteve e brendshme të armatosura.

- **Organizatat ndërkombëtare**

Duke studiuar lëndën Organizatat Ndërkombëtare studentët do të njihen me organizatat universale ndërkombëtare, organizatat rajonale, kryesisht evropiane, ndërkombëtare, funksionin, strukturën dhe mënyrën e tyre të punës.

- **E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut**

Kjo lëndë e analizon të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, paraqitjen dhe zhvillimin e kësaj lënde deri në ditët e sotme. Objekti i lëndës i përfshin instrumentet më të rëndësishme të kësaj materije, siç janë: Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave Ekonomike dhe Sociale, Konventa për Mbrojtjen e Grave nga Diskriminimi, etj. Gjithashtu, kjo lëndë i analizon mekanizmat e zbatimit të këtyre instrumenteve.

- **E drejta penale ndërkombëtare**

Në këtë lëndë, do të analizohen zhvillimet aktuale në të drejtën penale ndërkombëtare. Qëllimet e lëndës janë:

avancimi i njohurive të studentëve lidhur me të drejtën penale ndërkombëtare, me vështrim kritik ndaj institucioneve që e zbatojnë këtë të drejtë, si dhe zhvillimi i aftësive të studentëve për zbatim të normave nga e drejta penale ndërkombëtare.